

Universiteti i Arteve

Akademia e Filmit dhe Multimedias "Marubi"

Nr. 907 Prot.Nr. 66 Prot.Tiranë, më 22 / 05 /2025Tiranë, më 22 / 05 /2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

Universitetit të Arteve

dhe

Akademisë së Filmit dhe Multimedias "Marubi"

Sot, më 22 / 05 /2025 lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi midis palëve të mëposhtme:

1. **Universiteti i Arteve**, institucion publik i arsimit të lartë, i krijuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me NIPT **K51713024L** dhe seli në Rruga Bulevardi "Dëshmoret e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë, i përfaqësuar nga Rektori, Prof. Dr. Erald Bakalli (në vijim referuar si "Universiteti"),

dhe

2. **Akademisë së Filmit dhe Multimedias "Marubi"**, Institucion i Arsimit të Lartë i krijuar më 30.9.2004 me VKM Nr. 652, pjesë përbërëse e Fondacioni KINOSTUDIO me VKM Nr. 65/2017 me NIPT M42208452W me seli Rr. Aleksandër Moisiu Nr 78 Kinostudio -Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori Kujtim Çashku, (në vijim referuar si "Akademia").

Referuar këtu më poshtë individualisht si "**Pala**" dhe bashkërisht si "**Palët**".

Neni 1

Qëllimi i marrëveshjes

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është vendosja e një bashkëpunimi institucional për shkëmbimin e stafit akademik ndërmjet dy institucioneve, në funksion të ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe akademike, në fushën e arteve pamore, muzikës, dhe atyre skenike, kryesisht të filmit dhe audiovizualit.



Neni 2

Fushat e bashkëpunimit

1. Palët bien dakord të bashkëpunojnë për shkëmbimin e stafit akademik për mbajtjen e leksioneve në lidhje me fushat e artit dhe me interes reciprok.
2. Palët bien dakord që të mbështesin bashkëpunimin artistik studentor në realizimin e programeve akademike, me miratimin paraprak shkresor të drejtuesit të njësisë bazë dhe të titullarit të institucionit përkatës.

Neni 3

Modalitetet e shkëmbimit të stafit

1. Anëtari i personelit akademik me kohë të plotë i njëres palë, mund të angazhohet me kohë të pjesshme pranë palës tjetër, me miratimin e drejtuesit të njësisë bazë dhe të titullarit të institucionit.
2. Shkëmbimi i stafit do të bëhet në përputhje me nevojat akademike dhe mundësitë e secilës palë.
3. Çdo shkëmbim do të formalizohet përmes komunikimit shkresor zyrtar.

Neni 4

Përgjegjësitë e palëve

Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje, palët nuk ngarkohen me asnjë detyrim financiar.

Neni 5

Koordinimi dhe komunikimi

Secila palë do të caktojë një person ndërlidhës për ndjekjen e zbatimit të kësaj marrëveshjeje dhe për komunikimin nëpërmjet postës elektronike.

Për Universitetin e Arteve:

Person Kontakti: Prof. Asoc. Dorian Çene
Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë
E-mail: zvrektorimesimor@uart.edu.al

Për Akademinë e Filmit dhe Multimedias "Marubi":

Person Kontakti: Magali Perrichet Çashku
Drejtoresh e Produksioneve
Adresa: Rr. Aleksander Moisiu Nr. 78 - Kinostudio, Tiranë
E-mail: magali@afmm.edu.al



Neni 6

Shkaqet madhore

Palët bien dakord që nëse nuk do jenë të afta të përmbushin detyrimet e tyre, për arsye të grevave ose mosmarrëveshjeve të punës, të çrregullimeve civile, motit të keq, fuqive madhore ose shkaqeve të tjera të pashmangshme shkaktuar përtej mundësisë që ato kanë për t'i kontrolluar, kjo nuk do të konsiderohet si prishje e marrëveshjes.

Neni 7

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj.
2. Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë 3 (tre) vjeçare nga data e nënshkrimit, me të drejtë ripërtëritje.

Neni 8

Dispozita të përgjithshme

1. Mosmarrëveshjet e lindura midis palëve zgjidhen me mirëkuptim. Për çdo mosmarrëveshje, palët i drejtohen me shkrim njëra-tjetrës.
2. Nëse mosmarrëveshjet janë të një natyre që mund të çojnë në prishje të marrëveshjes, ose nëse për arsye të tjera objektive ndonjëra nga palët kërkon zgjidhjen e marrëveshjes, kjo mund të bëhet nëpërmjet një kërkesë me shkrim nga cilado palë, drejtuar palës tjetër brenda afatit 3 (tre) muaj ose 90 (nëntëdhjetë) ditor.
3. Kjo marrëveshje është formuluar në 4 (katër) kopje origjinale, identike, dhe është nënshkruar me vullnet të plotë dhe të lirë nga palët, pasi u lexua, u kuptua dhe u pranua prej tyre.

Për Universitetin e Arteve:

**Për Akademinë e Filmit dhe Multimedias
Marubi:**

REKTORI

Prof. Dr. Erald Bakalli



DREJTORI

Kujtim Çashku

